

## ROLI-DETYRAT-PËRGJEGJËSITË PËR NJË SHËRBIM SOCIAL TË PËRSHTATSHËM NDAJ QYTETARIT, - RIDE

*Studim mbi Politikat Sociale*

*Studimi mbi Politikat Sociale “Gjendja e Fëmijëve në Situata rruge” është një produkt i projektit “Roli – Detyrat – Përgjegjësitë për një shërbim social të përshtatshëm ndaj qytetarit – RIDE”, i cili mbështetet nga Fondi Europian për vendet e Ballkanit (EFB), një iniciativë e përbashkët e Fondacionit Robert Bosch, fondacionit “Compagnia di San Paolo”, fondacionit “ERSTE” dhe fondacionit “King Baudouin”, nëpërmjet programit Rajonal të studimit të politikave “Think and Link”*

*Përgatiti: Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Shqipëri*

*Tiranë, Dhjetor 2013*

### **Përmbledhje**

Fëmijët, për shkak të moshës së tyre, formimit papjekurisë mendore dhe fizike, janë grupi më shumë i ekspozuar ndaj rrezikut, dhe për këtë arsye ata kanë nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje të veçantë nga ana e familjeve të tyre, shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Përmirësimi i legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve ka qënë prioritet i të gjitha qeverive pas viteve 90 në Shqipëri. Ky prioritet është mbështetur gjithmonë nga lëvizjet e mbrojtësve të të drejtave të fëmijëve, promovuar nga institucionet ndërkombëtare si UNICEF-i dhe rrjete të tjera OJQ-sh. Megjithëse duhet përmendur se ekzistojnë mangësi dhe probleme midis legjislacionit të shkruar dhe implementimit të tij, legjislacioni garanton të drejta të barabarta për individët në nevojë dhe qytetarët e tjerë, pa marrë parasysh shkakun, natyrën dhe shtrirjen e ngjarjes.

Ky studim mbi politikat fokusohet në gjetjen e mangësive midis legjislacionit të shkruar dhe implementimit të tij në përmbushjen e detyrës kryesore për të garantuar mbijetesën, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve në situata rruge. Ka për qëllim të asistojë strukturat lokale të shërbimeve në implementimin efektiv dhe efikas të politikave dhe shërbimeve për grupet më vulnerabël të shoqërisë, veçanërisht për fëmijët në situata rruge.

### **Lista e shkurtimeve**

BKTF	Bashkë Kundër Trafikut të Fëmijëve
KDF (UN)	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NE	Ndihma Ekonomike
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
IKU	Instituti Kërkimor Urban
NJQV	Njësi e Qeverisë Vendore
MF	Ministria e Financave

MA	Ministria e Arsimit
MB	Ministria e Brendshme
MPCSSH	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
QKSHS	Qendra Kombëtare e Shërbimeve Sociale
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
ASHMDF	Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi I Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
BB	Banka Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

## I. Hyrje

Në prill 2012, në Shqipëri, u aprovua plani i veprimit i strategjisë kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve 2012-2015, dhe u morën masat për implementimin e Ligjit mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Firmosja e një urdhri të përbashkët midis MB<sup>1</sup> dhe MPÇSSHB<sup>2</sup> në gusht 2012, ka për qëllim rritjen e koordinimit për menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve në rrezik abuzimi. *Trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore, lypja e fëmijëve dhe puna joformale e fëmijëve mbeten çështje shqetësuese dhe është e nevojshme të adresohen sipas nevojave<sup>3</sup>. Puna e fëmijëve është duke prekur komunitetin Rom<sup>4</sup>. Proçesi i krijimit të njësive vendore të mbrojtjes së fëmijëve vazhdon, me gjithë rritjen e besimit tek shoqëria civile dhe donatorët për të ofruar shërbime. Progresi efektiv i implementimit varet nga forcimi i burimeve njerëzore dhe financiare dhe koordinimi midis nivelit qendror dhe lokal.<sup>5</sup> Ekziston mbështetja sistematike e organizatave të shoqërisë civile për të siguruar shërbimet e mbrojtjes së fëmijës në nivel lokal<sup>6</sup>.*

Ky punim mbi politikat sociale është hartuar për të mbështetur aktorët lokal përgjegjës (institucionet lokale, qeveria vendore dhe aktorë të tjerë përgjegjës dhe qytetarë) për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve të tyre për pjesën më vulnerabel të shoqërisë, fëmijët e rrugës. Ky punim mbi politikat bazohet në Legjislacionin Shqiptar, strategjitë dhe planet kombëtare, studime dhe takime në terren, në tre rajone të Shqipërisë: Fier, Vlorë dhe Tiranë.

*Duke ju referuar Human Rights Watch, - termi fëmijë rruge i referohet fëmijëve për të cilët rruga, më shumë se familja e tyre, është bërë shtëpia e tyre e vërtetë. Kjo përfshin fëmijë të cilët jo domosdoshmërisht janë të pastrehë ose pa familje, por jetojnë në situatë ku nuk ekziston mbrojtja, mbikqyrja, ose drejtimi nga të rriturit përgjegjës.*

<sup>1</sup> MB, - Ministria e Brendshme

<sup>2</sup> MPÇSSHB, - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

<sup>3</sup> “Shqipëria 2012 Progres Raporti”; Komunikatë e Komisionit të Parlamentit Europian dhe të Këshillit; Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013; Bruksel, 10.10.2012; faqe 19.

<sup>4</sup> Ibid, faqe 48.

<sup>5</sup> Ibid, faqe 54.

<sup>6</sup> Ibid, faqe 19.

Sipas UNICEF-it fëmijët e rrugës ndahen në tre kategori;

-*Fëmijë që jetojnë në rrugë*- fëmijë të cilët kanë ikur nga familjet e tyre dhe jetojnë vetëm në rrugë.

-*Fëmijë që punojnë në rrugë* - fëmijë që kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre në rrugë, kujdesen për veten e tyre, por kthehen në shtëpi rregullisht.

-*Fëmijët e familjeve të rrugës*- fëmijët që jetojnë në rrugë me familjet e tyre.

Çështja e përkufizimit të fëmijëve të rrugës ka qënë gjithmonë një debat i hapur, sepse ky grup nuk formon një kategori të përcaktuar qartësisht. Kërkimi dhe praktika kanë nxjerr në pah një ndryshim shumë të madh në përvojat e fëmijëve dhe një mbivendosje të konsiderueshme midis këtyre tre grupeve: për shembull disa fëmijë jetojnë në rrugë gjatë gjithë kohës, të tjerë vetëm me raste ose periodikisht, ndërsa të tjerë lëvizin midis shtëpisë, rrugës dhe qendrave të strehimit. Disa ruajnë lidhje të forta me familjet e tyre dhe të tjerë i kanë shkëputur lidhjet ose e kanë humbur plotësisht kontaktin. Përkufizimet vazhdojnë të evoluojnë, me terma si ‘fëmijë të lidhur me rrugën’ dhe ‘fëmijë në situatë rruge’, ose të përkufizohen fëmijët e rrugës si ‘fëmijë për të cilët rruga është pikë referimi dhe ka rol qëndror në jetën e tyre’. Megjithatë, shumëllojshmëria e rrethanave dhe karakteristikave të fëmijëve, vazhdon të paraqesë sfida shumë të mëdha përsa i përket përkufizimit.

Në legjislacionin Shqiptar dhe të gjithë aktorët e përfshirë me rastin e fëmijëve në situatë rruge, ka ende një mungesë konsensusi përsa i përket përkufizimit të fëmijës në situatë rruge. Rruga është thjeshtë një pikë referimi, por jo domosdoshmërisht vendi ku fëmija kalon shumicën e kohës së tij/saj.

Fëmijët mund të përfundojnë në rrugë për arsye të shumta dhe të përballen me shumë rreziqe si kushtet e këqija të jetesës, mungesa e strehimit, pamundësia e aksesit ndaj shërbimeve mjekësore dhe shëndetësore, pamundësia e aksesit ndaj shkollimit dhe edukimit, dhuna dhe kriminaliteti në rrugë, presioni ndaj përdorimit të drogës dhe shpërndarjes së saj, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual, gjymtim apo edhe vrasje nga trafikantët e qenieve njerëzore, përjashtimi social dhe marginalizimi. Nëse janë të braktisur, jetim apo të refuzuar nga prindërit e tyre, ata nuk kanë asnjë zgjidhje tjetër. Fëmijë të tjerë mund të zgjedhin të jetojnë në rrugë sepse janë të keqtrajtuar apo të neglizhuar nga familjet e tyre. Shumë fëmijë të tjerë punojnë në rrugë ose janë të detyruar ta bëjnë këtë nga familjet e tyre. Kuptohet se arsyeja kryesore është varfëria dhe përçarja e familjes, ku rol aktiv luajnë faktorët social, ekonomik, politik ose mjedisor. OBSH-ja (1993) ka hartuar një listë faktorësh të cilët mund të kontribuojnë në vulnerabilitetin e fëmijëve dhe ti çojnë ata drejt jetesës në rrugë, si për shembull<sup>7</sup>;

- përçarja e familjes,
- konflikti i armatosur,
- varfëria,
- katastrofat natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu,
- uria,
- abuzimi fizik dhe seksual,
- shfrytëzimi nga të rriturit,
- zhvendosje me anë të migrimit,
- urbanizimi dhe mbipopullimi,

---

<sup>7</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) (1993) “Rrugë me një drejtim? Raport mbi fazën I të Projektit mbi Fëmijët e Rrugës” pjesa 3 nga 9, [http://www.pangaea.org/street\\_children/world/who3.htm](http://www.pangaea.org/street_children/world/who3.htm)

- përjashtimi social, diskriminimi,
- refuzimi prindëror

Kombet e Bashkuara (2001) bien dakort me mendimin se cilat janë arsyet kryesore për fenomenin e fëmijëve të rrugës nëpër botë dhe neglizhencës. Këto fëmijë vijnë nga familje urbane, përgjithësisht të varfra ose në krizë martesore, ndërsa gjithmonë e më shumë zonat rurale po kontribuojnë në fenomenin e fëmijëve të rrugës. Gjithashtu, fëmijët e rrugës mund ti përkasin minoriteteve etnike nga shtetet fqinje ose komunitetet nomade të cilat janë vendosur në periferitë e qyteteve dhe/ose që janë larguar nga katastrofat natyrore. Ata gjithashtu mund ta kenë origjinën nga minoritetet politike apo fetare të përjashtuar nga shteti i tyre apo të refuzuar nga shkollat zyrtare për shkak të ngurtësisë së sistemit shkollor (UNESCO).

Bazuar në të gjitha përkufizimet ndërkomëtare dhe kombëtare, në këtë dokument mbi studimin e politikave *një fëmijë në situatë rruge*, do të referohet një fëmijë i cili është më i vogël se 18 vjeç, ka një lloj lidhje me rrugën (kryesisht jeton dhe/ose punon në rrugë edhe pse në periudha sezonale apo tranzitore) dhe përfshin:

1. Fëmijë që lypin apo lajnë xhamat e makinave vetëm ose të shoqëruar
2. Fëmijë të përfshirë në punësim joformal (riciklimi i plastikës ose metalit)
3. Fëmijë që shesin nëpër kryqëzime, kafene ose vende fikse ose ofrojnë shërbimin e parkimit të makinës
4. Fëmijë të përfshirë në shfrytëzimin seksual
5. Fëmijë në konflikt me ligjin (që transportojnë substanca narkotike, që kontrabandojnë apo vjedhin)

## II. Vështrim i përgjithshëm i situatës

Një qasje strategjike ndaj mirëqënies, veçanërisht për grupet më vulnerabël është e nevojshme të thellohet më shumë për të mos mbetur thjesht në nivelin e marrëveshjeve normative si, politikat e bazuara mbi të drejtat sensitive, ngritje kapacitetesh për aktorët e qeverisë vendore etj, të cilat jo gjithmonë ekspozojnë paragjykimet ndaj nevojave të vulnerabilitetit të qenësishme brenda sistemit. Vendi ku mund të ekzaminohet cilësia e qeverisjes së mirë nga një perspektivë bazuar në të drejtat është në pikat e kontaktit midis fëmijëve dhe shtetit. Është niveli rajonal dhe lokal ku personat vulnerabël shpesh kanë akses më të madh ndaj përgjigjes së shtetit në lidhje me përjashtimin, ku faktorët të cilët limitojnë mirëqënien e tyre dhe pjesëmarrjen e tyre në mjedisin social janë më të dukshëm dhe lehtësisht të adresueshëm.

Një sistem efektiv i përkujdesjes sociale konsiston në një sistem të integruar dhe të ndërlidhur ligjesh, rregulloresh, politikash, procedurash, institucionesh, mundësish dhe ofrues shërbimesh. Shumica e legjislacionit parësor në mbështetje të implementimit të reformës është në vendin e duhur.

Së fundmi Qeveria Qëndrore planifikon të decentralizojë përgjegjësitë dhe shërbimet sociale në nivel lokal. Ky është një hap i rëndësishëm në reformën e shërbimeve sociale por gjithashtu një sfidë e stërmadhe në reformën sociale. Në këtë proces fillestar të qeverisë vendore, vihet re një mungesë e dukshme e traditës, e eksperiencës në ofrimin e shërbimeve sociale të përshtatshme dhe të mbrojtjes për komunitetin përreth. Ka disa komuna/bashki të cilat janë të vetëdijshme për përgjegjësitë në lidhje me përmirësimin e situatës së grupeve vulnerabël të fëmijëve. Ata kanë nevojë të ndajnë eksperiencën të vlefshme, se si kolegët e tyre në shtete të tjera arrijnë, në nivel lokal, të menaxhojnë këto situata me qëllim hartimin e dokumentave të politikave lokale, procesi vendimmarrës nëpër këshillet bashkiake/të komunave, të lobohet për ngritje fondesh me agjensi donatore të ndryshme,

alokimi i fondeve dhe organizimi i shërbimeve sociale, si të përfshihet komuniteti në mënyrë aktive që të luajë rolin e tij dhe të kontribuojë në shërbimet sociale.

Një nga format më të këqija të shfrytëzimit të fëmijëve është lypja në rrugë. Në shumicën e rasteve janë vetë prindërit të cilët i detyrojnë fëmijët të lypin në rrugë, për shkak të varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. Fëmijët shpesh qëndrojnë duke lypur në rrugë deri në 12 orë në ditë, dhe ndonjëherë madje edhe deri natën vonë, dhe kjo është e dëmshme për zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe emocional. Fëmijët e rrugës janë më të ekspozuar ndaj dhunës gjatë kohës që qëndrojnë në rrugë. Këta fëmijë nuk e frekuentojnë shkollën.<sup>8</sup>

Ky fenomen është gjerësisht i përhapur në Vlorë. Format në të cilat shfaqet janë si më poshtë:

- *Fëmijët që lypin në rrugë:* ky fenomen përqëndrohet kryesisht tek fëmijët Rom. Familjet të cilat shfrytëzojnë fëmijët për të lypur janë më së shumti familje Rome të cilat vijnë nga Levani, Korça, Elbasani etj. Prindërit e fëmijëve e pranojnë faktin se janë duke i përdorur fëmijët për të lypur, por në mungesë të formave të tjera të mbijetesës, ata e shohin lypjen si një mënyrë jetese. Në qarkun e Vlorës ka mungesë shërbimesh, mungesë qendrash ditore ose mungesë kapaciteti në qendrat rezidenciale.
- *Fëmijët që punojnë në rrugë, ose në tregun e fshehtë nëntokësor:* Fëmijët janë të detyruar të mbledhin kanoçe nëpër koshat e plehrave. Punësimi i fëmijëve të moshës 14-16 vjeç në rrobaqepësi dhe ndërtim vazhdon të jetë problem. Ata nuk janë të deklaruar si të punësuar dhe ndërkohë thuhet se ata ndjekin shkollën rregullisht, me përjashtim të rasteve të njohura nga Inspektoriat i Punësimit për fëmijët që punojnë në fabrika. Për këtë kategori fëmijësh nuk ka informacione statistikore të sakta.
- *Fëmijët që shesin në rrugë:* ky fenomen është i dukshëm në stinën e verës. Gjatë verës prindërit i detyrojnë fëmijët e tyre të shesin në plazhe.
- *Fëmijët e përfshirë në shfrytëzimin seksual:* në 2012 ishin 2 raste të 2 vajzave 12 vjeçare të cilat janë shfrytëzuar seksualisht. Këto raste vazhdojnë të jenë të pazgjidhura.

### III. Problemet e hasura gjatë implementimit të legjislacionit për fëmijët në situatë rruge

Fëmijët në situatë rruge duke qenë se jetojnë në kushte ekstreme janë të privuar kryesisht nga :

- Shërbimet shëndetësore
- Mbrojtja sociale
- Edukimi dhe zhvillimi
- Pjesëmarrja

Ky kërkim mbi politikat sociale do të fokusohet tek roli i qeverisë vendore e cila duhet të njohë dhe të veprojë në mbështetje të dhënies së shërbimeve ndaj fëmijëve të rrugës.

#### a. Ligji mbi përkujdesin shëndetësor në Shqipëri me fokus tek fëmijët në situatë rruge

<sup>8</sup> Strategjia Rajonale për Fëmijët, Qarku Fier 2012-2015.

Ka disa ligje të cilat rregullojnë shërbimet shëndetësore në Shqipëri. Midis ligjeve më të rëndësishme është ai mbi Përkujdesin Shëndetësor në Shqipëri<sup>9</sup>.

Fëmijët që jetojnë në situatë rruge janë fëmijë të cilët jetojnë pa kujdes prindëror dhe shpesh nuk janë të pajisur me asnjë dokument regjistrimi të lindjes. Edhe pse aksesimi ndaj shërbimeve bazë dhe atyre të specializuara bëhet vetëm nëpërmjet librezës shëndetësore, ofrimi i kujdesit shëndetësor është pothuajse i pamundur për këtë grup fëmijësh. Mungesa e librezës shëndetësore diskriminon fëmijët e familjeve Rome por gjithashtu ato të gjithë familjeve të tjera të cilat nuk paguajnë sigurime shëndetësore për shkak të papunësisë dhe varfërisë. Pajisja me librezë shëndetësore nuk varet nga fëmijët. Është përgjegjësi e prindërve dhe të rriturve të tjerë përgjegjës për fëmijët. Vështirësitë e të rriturve vënë në rrezik statusin e fëmijëve ndërsa qeveria nuk është në gjendje të kompensojë këtë fakt me ndërhyrje të cilat kanë për qëllim arritjen e respektimit të parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe Kushtetutës. Ofrimi i shërbimit shëndetësor për këtë kategori fëmijësh shumicën e kohës mbetet në dorë të dëshirës së mirë të stafit shëndetësor.

Aktualisht i vetmi shërbim i cili ofrohet falas është vaksinimi. Situata e shërbimit shëndetësor për këtë grup, është edhe më e rëndë përse i përket shërbimeve të specializuara si dentisti, okulisti, psikologu, etj. shërbime të cilat ofrohen me pagesë.

#### *b. Mbrojtja Sociale dhe Ndihma Sociale për fëmijët në situatë rruge*

Ligji Nr. 9355 është një nga ligjet bazë që garanton asistencë ekonomike dhe shërbime sociale për mbrojtjen e fëmijës. Na ndihmon të kuptojmë pse kaq shumë fëmijë që jetojnë në situatë rruge nuk kanë përfituar asnjëherë nga implementimi i tij. Ky ligj nuk fokusohet në grupe specifike fëmijësh dhe në lloje suporti sipas nevojave pasi ai konsideron të gjithë fëmijët në nevojë për asistencë ekonomike dhe shërbime sociale si një grup i vetëm unik. Do të ishte e përshtatshme për shërbime specifike të ofruara ndaj fëmijëve, veçanërisht atyre që i kanë mbijetuar situatave ekstreme të abuzimit dhe shfrytëzimit, të adresoheshin në një mënyrë specifike të lidhur me organizimin dhe ofrimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale, njëkohësisht në nivel kombëtar dhe rajonal ose bashkiak. Skema e ligjit e vendos pothuajse të gjithë peshën e ofrimit të shërbimeve sociale mbi bashkitë dhe komunat dhe kërkon prej tyre ngritjen e zyrave të posaçme për këtë gje (Neni 30). Megjithatë, nga viti 2005 deri sot, me përjashtim të bashkive të mëdha, pothuajse asnjë nga bashkitë dhe komunat në Shqipëri nuk kanë zyrë të posaçme për ofrimin e shërbimeve sociale; ata kanë vetëm një ose disa persona të cilët, midis gjërave të tjera, mbulojnë dhe obligimet e lindura nga implementimi i këtij ligji. Në Këshillin Rajonal të Rethit të Fierit në kuadër të implementimit të Nenit 30 të Ligjit 9355, në 2008 u ngrit dhe filloi funksionimin Departamenti i Shërbimeve të Mirqënies Sociale. Në vitin 2006, një vit pasi Ligji filloi të implementohet, në Bashkinë Fier zyra e Ndihmës Ekonomike u kthye në zyrën e shërbimeve sociale. Në të gjitha Bashkitë dhe Komunat e tjera ky funksion mbulohet nga Administratori Social, i cili midis funksioneve të tjera është gjithashtu përgjegjës për këtë funksion. E njëjta situatë është dhe në qarkun e Vlorës. Me përjashtim të Bashkive kryesore (bashkia Vlorë, Sarandë dhe Delvinë), ky funksion kryehet nga Administratori Social.

---

<sup>9</sup> Ligji Nr.10107, Date 30.3.2009, Mbi kujdesin shëndetësor në Shqipëri. Duke analizuar këtë ligj vihet re se: Neni I këtij ligji, i cili flet për parimet e kujdesit shëndetësor në Shqipëri, thotë në dy nga paragrafet e tij: 'a) e drejta për kujdes shëndetësor, një e drejtë themelore e individit; b) garantim i të drejtave të barabarta për kujdes shëndetësor, bazuar mbi jo diskriminimin; ndërsa, në nenin 3, paragrafi 3 thuhet: "Kujdesi shëndetësor është një grumbull masash dhe aktiviteteve të ndërmara nga institucionet shëndetësore, punonjësit e shëndetësisë dhe qytetarët, me qëllim përmirësimin e mirëqënies së përgjithshme fizike, mendore dhe sociale të qytetarëve." Ligji shpjegon mënyrat e financimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Neni 8 parashikon që kujdesi shëndetësor të financohet nga: a) Buxheti i Shtetit; b) sigurimi shëndetësor i detyrueshëm ose vullnetar c) sigurimi shëndetësor privat; d) pagesa direkte.



Një tjetër problem i identifikuar në një mbledhje me Kryetarin e Komunës Novosel (qarku Vlorë), është integrimi i personave që janë pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike (NE) në punë komunitare. Ai deklaroi se *“Mendoj se do të ishte ideale nëse përfituesit e ndihmës ekonomike do të duhej të punonin për të përfituar paratë e tyre. Ka gjithmonë shërbime komunitare të cilat duhen kryer, ata mund të punojnë një numër të caktuar orësh duke mbledhur papastëritë ose punë kopshtarie në vend që të përfitojnë pa u lodhur. Kjo do të rriste vetëbesimin e tyre, duke qenë se do të ishin duke bërë diçka për komunitetin në vend që të vareshin plotësisht nga sistemi dhe fëmijët e tyre do të kuptonin se çdo gjë në jetë fitohet, në vend që të dalin në rrugë për të lypur”*

Institucioni i Shërbimit Social Shtetëror në qarkun e Fierit dhe në qarkun e Vlorës nuk mbledh të dhëna rreth fëmijëve në situatë rruge. Mbledhja e të dhënave për këtë kategori ka qenë praktikë e këtij institucioni vite më parë dhe i specifikonte të dhënat për fëmijët që jetojnë në familje me shtëpi ose pa shtëpi. Përgjegjësia zakonisht delegohet nga një institucion tek tjetri. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet se ky institucion është përgjegjës për Ndihmën Ekonomike (NE) ose personat me nevoja të veçanta dhe nuk mbledh të dhëna për fëmijët në situatë rruge.

Bazuar në Nenin 29 të Ligjit, qeveria vendore luan rol vendimtar në përcaktimin e tipit dhe nivelit të shërbimeve që ofrohen në territorin e tij<sup>10</sup>.

Në shumicën e rasteve fëmijët në situatë rruge praktikojnë profesionin e lypsave dhe në raste më të rralla, profesionin e shitësve ambulantë. Fenomeni është gjerësisht i përhapur në zonat urbane. Deri në ndryshimin e kodit penal, as kodi penal as ligjet e tjera në Shqipëri nuk e ndalonin lypjen si fenomen, duke përfshirë dhe lypjen nga fëmijët. Në maj të 2013 u bë një ndryshim i Nenit 124/b i Kodit Penal dhe sipas këtij neni “shfrytëzimi i detyruar i të miturve për të punuar, për të sjellë të ardhura, për të lypur ose të kryejë akte të cilat prekin zhvillimin e tij mendor/fizik, ose edukimin e tij dënohet nga dy deri në pesë vjet burgim”.

### *c. Edukimi bazë për fëmijët në situatë rruge*

Shqipëria ka miratuar Ligjin mbi Arsimin Para Universitar nr 69/2012, datë 21.06.2012 dhe Strategjinë Kombëtare mbi Arsimin Para Universitar 2009-2013. Këto janë dy dokumente shumë të rëndësishme për zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Të dy dokumentet deklarojnë qëllimin për të rritur pjesëmarrjen në edukimin e detyrueshëm veçanërisht për fëmijët që vijnë nga familjet e varfra, dhe për këtë ata parashikojnë klasa përgatitore për fëmijët në nevojë, duke përfshirë dhe fëmijët e komunitetit Rom.

Progres raportet e Ministrisë së Arsimit deklarojnë se gjatë viteve 2003-2004, Ministria e Arsimit ka shpërndarë tekste shkollore falas për fëmijët në nevojë dhe fëmijët Rom. Sipas VKM nr 212, datë 16.03.2011 “Mbi publikimin, printimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve edukative të sistemit para-universitar”, deklarohet se tekstet për fëmijët Rom dhe për disa kategori të tjera në nevojë, në arsimin e detyrueshëm janë 100% të rimbursuara nga buxheti i MA. Për këtë fakt të gjitha drejtoritë e shkollave duhet të dorëzojnë një listë me emrat e fëmijëve Rom tek Drejtoria Arsimore Rajonale. Fëmijët e komunitetit Egjiptian dhe komuniteteve të tjera janë të përjashtuar nga skema e rimbursimit, dhe ky është problem pasi këto komunitete kanë të njëjtat nevoja si komuniteti Rom.

Një problem tjetër është rimbursimi i teksteve në gjimnaz. Bazuar në vëzhgimet në terren dhe intervistat me 3 organizata (një organizatë ombrellë dhe dy të tjera që punojnë mbi edukimin e fëmijëve Rom), nuk ekziston asnjë akt ligjor që jep mundësinë e përfitimit të teksteve falas për

<sup>10</sup> Përgjegjësia e Këshillit bashkiak ose të komunës (qeveria vendore) në lidhje me ofrimin e asistencës ekonomike dhe shërbimit social është:

- Të hartohet plani për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social bazuar në burimet lokale, nevojat dhe prioritetet;
- Të aprovohet dhe mbështetet zhvillimi i shërbimeve të përkujdesit bazuar në vlerësimin e nevojave prioritare lokale;
- Të meren vendime mbi individët, familjet dhe tippet e shërbimeve për tu ofruar bazuar në vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve e bërë nga Administratori Social dhe munësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve



fëmijët Rom në gjimnaz. Ata gjithashtu nuk kanë as mundësinë e përfitimit të rimbursimit të pjesëshëm për tekstet shkollore në gjimnaz. Mundësia e teksteve falas dhe akti ligjor për këtë dispozitë është vetëm për edukimin e detyrueshëm.<sup>11</sup>

Problemi që rrjedh prej këtij fakti është se VKM-ja për shpërndarjen e teksteve shkollore falas për fëmijët Rom dhe VKM-ja për rimbursimin e librave për fëmijët që vijnë nga familje me të ardhura të limituara nuk janë implementuar plotësisht dhe me sukses. Fëmijët Rom nuk i marrin librat e tyre falas sepse disa prej tyre nuk e frekuentojnë shkollën pasi nuk janë regjistruar në Zyrat e Gjendjes Civile dhe fëmijët e familjeve të varfra nuk kanë para për të blerë librat paraprakisht dhe si pasojë, nuk mund të ketë rimbursim për ta. Për të theksuar rëndësinë e këtij problemi, gjatë të njëjtës ditë Kryetari i komunës së Shushicës në qarkun e Vlorës tha se shpërndarja e teksteve shkollore falas nuk kishte filluar në shkollat e kësaj komune, dhe në të njëjtën ditë një nga specialistët e Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë u shpreh se kjo fazë ishte përmbyllur me sukses në të gjitha shkollat e qarkut të Vlorës.

Edukimi i fëmijëve në situatë rruge përballlet me probleme të ndryshme:

- i. Ekziston një kuadër ligjor i cili garanton edukimin për të gjithë fëmijët, por mekanizmat e kontrollit të implementimit të tij mungojnë.
- ii. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë fuqinë dhe aftësinë për të zbatuar ligjin. Strukturat e tyre nuk janë të afta për të identifikuar fëmijët në moshë shkollore. Ata nuk e ndjekin regjistrimin dhe përfshirjen e fëmijëve. Kur familjet janë të paregjistruara situata bëhet edhe më problematike sepse nuk ekziston pothuajse asnjë mundësi ndërhyrje.
- iii. Kur fëmijët në situatë rruge regjistrohen në shkollë falë suportit dhe shërbimeve të organizatave, ata përballen me vështirësi të tjera në lidhje me frekuentimin për shkak të:
  - a. Paragjykimit dhe diskriminimit nga fëmijët e tjerë, prindërit e tyre dhe mësuesit;
  - b. Mësuesit nuk tregojnë interes në përfshirjen e tyre në aktivitete duke i injoruar ata, duke mos treguar vëmendje ndaj tyre dhe duke mos i dhënë mundësinë për tu përfshirë;
  - c. Shërbimi i psikologut në shkollë është tërësisht formal dhe nuk ofron shërbime konkrete ndaj fëmijëve në situatë rruge;
  - d. Fëmijët nuk e ndjekin shkollën në mënyrë aktive dhe kalojnë klasën në fund të vitit. Ky veprim dëmton fëmijën dhe në një lloj mënyre zyrtarizon këtë formë të vepruarit;

Duke u bazuar në këtë situatë identifikohen si nevoja 3 çështje:

### **1. Përfshirja e fëmijëve Rom në edukim**

- Ti ofrohet edukimi fëmijëve Rom duke hequr procedurën standarte të regjistrimit për këtë kategori
- Qeverisja Vendore duhet të jetë ajo e cila identifikon fëmijët në moshë parashkollore, problemet e tyre dhe bën të mundur që ata të kenë dokumentacionin përkatës
- Riaktivizim efektiv dhe implementim i Direktivës Nr.6 të MASH, datë 29.03.2006 “Për regjistrimin në shkollë të fëmijëve Rom të cilët nuk disponojnë certifikatë lindje”, e cila sugjeron hapjen e një regjistri special për fëmijët që nuk janë të regjistruar.

### **2. Vazhdimësia e procesit të edukimit për fëmijët Rom**

- Të raportohet braktisja e fshehtë dhe mosfrekuentimi gjatë orëve të mësimit duke ngritur struktura monitorimi
- Të realizohet një studim nga ana e MASH me qëllim vlerësimin e kostove financiare të futjes së ushqimit nëpër shkollë

<sup>11</sup> Danjela Shkalla, Koordinatore tek koalicioni “BKTF” (Shtator 2013)

- Praktikimi i transfertave “cash” të kushtëzuara, si praktikë pozitive e njohur në stimulimin e nxënësve dhe familjeve të tyre, që fëmijët të vijojnë shkollën
- Të ofrohen bursa studimi për këtë kategori fëmijësh në gjimnaz

### 3. Ofrimi i teksteve shkollore falas

- Të rishikohet Direktiva Nr.32 e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit, datë 04.08.2011, “Mbi procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për publikimin, printimin , shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore para universitare”, duke zgjeruar traget grupin dhe duke thjeshtuar procedurat. Të implementohet Direktiva në një mënyrë efektive dhe funksionale.
- Të krijohet një paketë e cila përveç teksteve shkollore të përfshijë edhe mjete dhe pajisje të tjera shkollore të nevojshme.
- Të qartësohen dhe detajohen detyrat dhe përgjegjësitë specifike të palëve të interesuara të cilat marrin pjesë në procesin e shpërndarjes së teksteve shkollore falas dhe materialeve shkollore
- Të ngrihet një strukturë monitoruese për të monitoruar shpërndarjen e teksteve

#### *d. Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në situatë rruge*

Neni 39 i Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 “Mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, prezanton Njësine e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) si struktura e cila ofron shërbime për fëmijët në situatë rruge, fëmijët e shfrytëzuar, fëmijët e trafikuar dhe të abuzuar. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës është pjesë e strukturës së Departamentit të Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike në nivel Bashkie/Komune. Ofron shërbime të mbrojtjes sociale për fëmijët dhe familjet të cilat jetojnë në mënyrë të përhershme apo përkohësisht brenda territorit ku ajo implementon përgjegjësitë e veta. Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Mbrojtjes në të gjithë territorin është i rëndësishëm jo vetëm sepse i përgjigjet kërkesave të Ligjit, por tani shihet si një strukturë e cila ofron shërbime sociale dhe koordinon përpjekjet për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, dhuna, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Bazuar në intervistat me institucionet lokale të cilat përballesh me rastet e fëmijëve në situatë rruge, procedura që ndiqet që nga momenti i identifikimit të një fëmije në situatë rruge është si vijon. Kur dikush përballet me një rast fëmije në situatë rruge telefonon centralin e policisë (numri 129) dhe në raste shumë të rralla njerëzit të cilët janë në djeni të sistemit informojnë Njësine e Mbrojtjes së Fëmijës. Edhe pse patrulla e policisë e merr thirrjen, problemi mbetet i pazgjidhur për fëmijën për shkak të mungesës së infrastrukturës për të akomoduar fëmijën në një qendër ditore ose rezidenciale. Bazuar në një urdhër të brendshëm të përbashkët midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ( 23 gusht 2012), në rast identifikimi të një fëmije në situatë rruge, inspektori i policisë dhe Shërbimi Social Shtetëror plotësojnë një procesverbal dhe fëmija dërgohet përkohësisht në një institut rezidencial në Vlorë, Durrës ose Shkodër.

#### ***Fëmijët në situatë rruge në syrin e institucioneve publike dhe jo publike***

Deri në 2012 në të gjithë territorin ishin 146 Njësi të Mbrojtjes së Fëmijës në nivel Bashkie dhe Komune<sup>12</sup>. Numri total (i rasteve) të fëmijëve të identifikuar në situatë të rrezikshme, për vitin 2012, ishte 1333. Informacioni i detajuar për secilin rreth ndodhet në tabelën e mëposhtme (nr 1):

<sup>12</sup> Berat-17, Diber-15, Durrës-13, Elbasan-32, Fier-11, Gjirokaster-1, Korçë-3, Kukës-11, Lezhë-10, Shkodër-5, Tiranë-15, Vlorë-13;

Nr	Qarku	Numri i fëmijëve që jetojnë në situatë të rrezikshme, - viti 2012
1	Berat	74
2	Diber	57
3	Durres	103
4	Elbasan	234
5	Fier	103
6	Gjirokaster	109
7	Korce	99
8	Kukes	96
9	Lezhe	33
10	Shkoder	88
11	Tirane	130
12	Vlore	207
<b>Total</b>		<b>1333</b>

*Tabela 1:* Numri i Fëmijëve që jetojnë në situatë të rrezikshme, - viti 2012

*Burimi:* Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (Qershor 2013), MPCSSH

Vetëm në 2012 u hapën 293 dosje rastesh të fëmijëve të cilët jetojnë në situatë të rrezikshme:

Nr	Qarku	Numri i rasteve të reja të fëmijëve që jetojnë në situatë të rrezikshme, - identifikuar gjatë vitit 2012
1	Berat	19
2	Diber	4
3	Durres	4
4	Elbasan	84
5	Fier	25
6	Gjirokaster	15
7	Korce	16
8	Kukes	10
9	Lezhe	2
10	Shkoder	8
11	Tirane	79
12	Vlore	27
<b>Total</b>		<b>293</b>

*Tabela 2:* Numri i rasteve të reja të fëmijëve që jetojnë në situatë të rrezikshme, - identifikuar gjatë vitit 2012;

*Burimi:* Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (Qershor 2013), MPCSSH B

Gjatë të njëjtit vit (2012) numri i rasteve të mbyllura, ose fëmijët e larguar nga rruga ishin 308. Të dhënat e detajuara për të gjitha rrethet janë paraqitur në tabelën nr. 3. Numri më i madh i fëmijëve të larguar nga rruga është në qarkun e Dibrës (54) dhe më i ulti është në Berat (3). Një nga problemet e identifikuar me rastet e fëmijëve që largohen nga rruga është se nuk ekziston një strukturë monitoruese e cila mbikqyr në vazhdimësi këto raste, nëse ata kthehen në rrugë apo janë raste plotësisht të suksesshme.

Nr	Qarku	Numri i rasteve mbyllura 2012
1	Berat	3
2	Dibër	54
3	Durrës	19
4	Elbasan	34
5	Fier	12
6	Gjirokastër	20
7	Korçë	34
8	Kukës	11
9	Lezhë	16
10	Shkodër	56
11	Tiranë	23
12	Vlorë	26
<b>Total</b>		<b>308</b>

*Tabela 3:* Numri i fëmijëve të larguar nga rruga, - identifikuar gjatë vitit 2012;

*Burimi:* Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (Qershor 2013), MPCSSH B

Të dhënat e sipërpërmendura janë ofruar nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) në MPCSSH B, pra këto janë të dhëna zyrtare të mbledhura nga institucionet publike përgjegjëse.

Ndërkohë në Qershor 2013 ARSIS Organizata për Mbështetjen Sociale të Rinisë drejtoi studimin “Analiza e fëmijëve në situatë rruge në nivel kombëtar”. Studimi kishte për qëllim të kuptonte madhësinë e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri. Bazuar në këtë studim në fazën e parë<sup>13</sup> ata numëruan fëmijët në situatë rruge në 8 Qarqe të Shqipërisë<sup>14</sup> dhe në fazën e dytë<sup>15</sup> ata

<sup>13</sup> Dy javë numërim fëmijësh në situatë rruge në Gusht 2013

<sup>14</sup> Tirana (Kavaja dhe Rrethi i Tiranës), Durrës (Qyteti i Durrësit, zonat e plazhit të Golemit dhe Gjiri i Lalzit), Vlora (Qytetet e Sarandës dhe Vlorës, zonat e Borshit, Dhërmiut, Drimadhes, Ksamil, Himarë), Dibër (Qyteti i Peshkopisë, Burrel, Bulqizë, Milot dhe zonat e Klosit), Elbasan (Qyteti i Elbasanit dhe qytetet e Peqinit, Cërrik, zona e Paper), Fier (Qyteti i Fierit, zona e plazhit të Divjakës, plazhi Seman), Shkodër (Qyteti i Shkodrës dhe Lezhës, zonat e Tale, Shëngjin, Velipojë, pika kufitare Murriqan); Korça (Qyteti i Pogradecit);

numëruan fëmijët në situatë rruge në të gjitha rrethet e territorit(12 rrethe)<sup>16</sup>. Rezultatet mbi numrin e fëmijëve në situatë rruge të mbledhura nga faza e parë e studimit janë si më poshtë:

Nr	Qarku	Numri i fëmijëve në situatë rruge - Gusht 2013
1	Dibër	217
2	Tiranë	636
3	Durrës (Golem, Gjiri i Lalzit)	376
4	Kavajë	203
5	Elbasan	69
6	Pogradec	52
7	Vlorë (Dijvakë)	88
8	Sarandë	161
9	Shkodër	214
<b>Total</b>		<b>2016</b>

*Tabela 4:* Numri i fëmijëve në situatë rruge – identifikuar në gusht 2013


*Burimi:* ARSIS Organizata për Mbështetjen Sociale të Rinisë “Analiza e fëmijëve në situatë rruge në nivel kombëtar– Faza e Parë”;

Nëse krahasojmë të dhënat zyrtare të ofruara nga ASHMDF dhe të dhënat e ofruara nga studimi në terren i ARSIS edhe pse të dhënat kanë vetëm një vit diferencë nga njëri-tjetri (2012 dhe 2013), ndryshimi midis të dhënave është i thellë. Në 2012 të dhënat nga institucioni publik afirmojnë se numri i fëmijëve që jetojnë në situatë të rrezikshme në të 12 qarqet e Shqipërisë është 1333. Bazuar në studimin në terren të një institucioni jo publik (ARSIS) numri i fëmijëve në situatë rruge në 8 qarqe të Shqipërisë për 2013 është 2016. Mund të shihet se ndryshimi është sinjifikativ nëse kemi parasysh se studimi është bërë vetëm për 8 qarqe dhe të dhënat për 4 qarqet e tjera mungojnë. Në grafikun nr. 1 mund të shihet ndryshimi i numrit të fëmijëve në situatë rruge në nivel rajonal për të dyja burimet (instituti publik dhe jo publik):

<sup>15</sup> Dy jave numerim femijesh ne situatë rruge ne Tetor 2013

<sup>16</sup> Tirana (rrethi I Tiranës, rrethi I Kavajës, Rogozhina, zonat e Kamzës dhe Vores); Durrës (rrethi I Durrësit, rrethi I Krujës, Fushkruja, zonat e Shijakut, Manez dhe Sukth); Vlorë (rrethi I Sarandës, Delvina dhe Vlorë, zonat e Ksamilit Vriion, Himara); Dibër (Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Klos dhe zonat e Suc, Shupenze); Elbasan (rrethi Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin Belsh, Perrenjas Cerrik, Paper); Fier (rrethi Fier, Lushnje, Ballsh, Patos, Rroskovec, Seman); Shkodër (rrethi Shkodër; Malesi e madhe, Pukë, Fusharëz, Tale, pika kufitare e Murriqanit); Korçë (rrethi Korçë; Pogradec, Devoll, Kolonjë, Bilisht, Leskovik, Maliq); Kukës (rrethi Kukës, Bajram Curri, Kruma); Lezhë (rrethi Lezhë, Mirdita, Kurbin); Gjirokastrë (rrethi Gjirokastrë; Tepelena, Permet, Kelcyra, Memaliaj); Berat (rrethi Berat, Kucovë, Skrapar)

## Numri i fëmijëve në situatë rruge - krahasim të dhënash nga burime publike dhe jo publike (viti 2012&2013)



*Grafiku 1:* Numri i fëmijëve në situatë rruge – krahasim të dhënash nga institucionet publike dhe jopublike

*Burimi:* ASHMDF (2012) dhe ARSIS (2013)

Nga grafiku mund të themi se ndryshimet janë sinjifikative në të gjitha qarqet e analizuar. Situata bëhet edhe më kritike nëse marrim në konsideratë faktin që në qarqet ku u numëruan fëmijët nga observimet në terren, jo të gjitha rrethet/pjesët e qarqeve u observuan<sup>17</sup>. Periudha gjatë së cilës u bë numërimi i fëmijëve në situatë rruge, ishte gusht 2013 dhe korespondon me periudhën e pushimeve dhe të muajit të Ramazanit, pra qarqet/zonat e analizuar në këtë pjesë janë qarqet më fetare në Shqipëri (Dibër, Shkodër, Elbasan), janë zonat bregdetare (Durrës dhe Vlorë) ose zonat kufitare (Korçë) dhe kryeqyteti i Shqipërisë (Tirana). Probabiliteti për migrim i familjeve që jetojnë në rrugë është i lartë në këto zona. Në qarkun e Tiranës numri i fëmijëve në situatë rruge është më shumë se 6 herë më i lartë, në qarqet Dibër, Durrës dhe Shkodër është më shumë se 3 herë më i lartë, në qarkun Korçë është 2 herë më i lartë bazuar në krahasimin e të dhënave midis institucionit publik dhe jo-publik.

Në fazën e dytë të numërimit numri i fëmijëve në situatë rruge u rrit në krahasim me fazën e parë. Të dhënat për fazën e dytë janë paraqitur në tabelën nr. 5:

<sup>17</sup> Tirana (Kavaja dhe Rrethi i Tiranës), Durrës (Qyteti i Durrësit, zonat e plazhit të Golemit dhe Gjiri i Lalzit), Vlorë (Qytetet e Sarandës dhe Vlores, zonat e Borshit, Dhermiut, Drimadhes, Ksamit, Himare), Dibër (Qyteti i Peshkopisë, Burrel, Bulqizë, Milot dhe zonat e Klosit), Elbasan (Qyteti i Elbasanit dhe qytetet e Peqinit, Cerrik, zona e Paper), Fier (Qyteti i Fierit, zona e plazhit të Divjakës, plazhi Seman), Shkodër (Qyteti i Shkodrës dhe Lezhës, zonat e Tale, Shengjin, Velipoje, pika kufitare Murriqan); Korçë (Qyteti i Pogrdëcit);

Nr	Qarku	Numri i fëmijëve në situatë rruge - Tetor 2013
1	Tirana	509
2	Dibër, Kukës, Rrëshen and Rubik	165
3	Gjirokaster, Berat	480
4	Korce, Elbasan	265
5	Durres, Kavaja	367
6	Shkoder, Lezha	514
7	Vlora, Saranda, Fier	227
<b>Total</b>		<b>2527</b>

*Tabela 5:* Numri i fëmijëve në situatë rruge – identifikuar në Tetor 2013

*Burimi:* ARSIS Organizata për Mbështetjen Sociale të Rinisë “Analiza e fëmijëve në situatë rruge në nivel kombëtar – Faza e Dytë”;

Numri i fëmijëve në situatë rruge në fazën e dytë të numërimit është rritur nga 2016 në 2527 fëmijë. Gjatë fazës së dytë të numërimit (Tetor 2013) u observuan tendenca të reja në disa zona në krahasim me stadin e parë, si Gjirokastra, Kavaja dhe Shkodra.

-lëvizjet e komunitetit Rom nga një qytet në tjetrin (punëtor sezonal)

-modele të reja pune në disa zona (puna përgjatë segmenteve kombëtare)

- komunitete të reja (në Shkodër u krijua një komunitet familjesh të ardhura nga qytete të tjera me problemin e përbashkët të gjakmarrjes)

Nuk mund të bëhet një krahasim ndryshimesh në nivel rajonal për dy periudhat dhe me të dhënat e mbledhura nga institucioni publik, sepse të dhënat e fazës së dytë janë të grupuara në 2 ose 3 qarqe.

Bazuar në observimet në terren të bëra në disa nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës të qarkut Fier theksohet se në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës në komunën Qendër nuk ka asnjë fëmijë në situatë rruge. Kjo situatë ndryshon herë pas here dhe varet nga situata e disa familjeve Rome në qark. Rezultoni se të gjithë fëmijët e kësaj komune janë të regjistruar në shkollë dhe të imunizuar. Në një nga shkollat e kësaj komune këtë vit 50 fëmijë të komunitetit Rom u regjistruan dhe filluan shkollën<sup>18</sup>

E njëjta situatë është në komunat Levan dhe Fratar. Numri i fëmijëve në situatë rruge në këto komuna është 0. Njësia e Mbrojtjes nuk ka hasur ndonjë rast dhe nuk ka pasur raportime nga qytetarët për fëmijë në situatë rruge.

Në komunën Lushnje numri i fëmijëve në situatë rruge është 17. Ata janë të grupmoshës 4-15 vjeç. Disa prej tyre e kanë braktisur shkollën (11 fëmijë) dhe disa prej tyre e ndjekin shkollën jo rregullisht. Familjet e tyre janë pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike.

Në bashkinë Lushnje u identifikuan 2 raste fëmijësh në situatë rruge. Specialisti i Njësisë së Mbrojtjes së kësaj bashkie thotë se ka më shumë raste fëmijësh në situatë rruge, por ata lypin në

<sup>18</sup> Rrapi Vogli, NJMF Qendër



qytete të tjera, dhe për këtë arsye identifikimi i tyre është tepër i vështirë. Drejtoria Arsimore e Bashkisë Lushnje ka një program special për fëmijët e braktisur, fëmijët që lypin dhe fëmijët e komunitetit Egjiptian. Programi quhet “Shansi i Dytë” dhe implementohet në dy shkolla. Ata kanë krijuar një klasë në secilën prej shkollave ku janë regjistruar të gjithë fëmijët në situatë rruge, që lypin dhe janë analfabetë. Fëmijët janë të grupmohave të ndryshme dhe deri në klasë të pestë mësojnë si të lexojnë e të shkruajnë.

Nga observimet në qarkun e Vlorës, vetëm Bashkia Vlorë është përballur me 4 raste fëmijësh në situatë rruge. Të gjitha institucionet e tjera (Shërbimi Social Shtetëror, Policia, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës) nuk janë përballur me asnjë rast fëmije në situatë rruge gjatë vitit 2013. Në një periudhë 3 vjeçare (nga 2000), Njësia e Mbrojtjes në Bashkinë e Vlorës ka menaxhuar 8 raste nga të cilat 4 janë zgjidhur dhe 4 janë ende duke u menaxhuar. Nga këto raste 2 prej tyre kanë marrë shërbime nga qendrat shëndetësore. Të 8 rastet janë identifikuar dhe shoqëruar në rajonin e policisë. Pas disa orësh fëmijët janë liruar për shkak të mungesës së shërbimeve dhe hapësirës. Qendrat shëndetësore në Qarkun e Vlorës nuk disponojnë një plan ndërhyrje në përballje me fëmijët në situatë rruge. Ata ofrojnë shërbime shëndetësore falas kur një fëmijë në situatë rruge paraqitet në qendrat shëndetësore dhe informojnë menjëherë Njësinë e Mbrojtjes, Policinë dhe Shërbimin Social Shtetëror.

### ***Debati i ofrimit të shërbimeve midis institucioneve publike (shtetërore) dhe atyre jo-publike (OJQ-t).***

Ka pasur një debat të vazhdueshëm për ofrimin e shërbimeve për familjet në situatë rruge dhe veçanërisht për fëmijët e këtyre familjeve. Institucionet shtetërore janë ato të cilat formojnë sistemin e konsoliduar për të gjithë qytetarët dhe janë në shërbim të gjithë popullsisë për ti siguruar atyre realizimin e të gjitha të drejtave të tyre si qenie njerëzore. Në anën tjetër ndodhen OJQ-t të cilat kanë qenë gjithmonë struktura mbështetëse për institucionet shtetërore dhe kanë qenë gjithmonë struktura ofruese të shërbimeve. Problemi i ofrimit të shërbimeve nga OJQ-t është se ato zakonisht operojnë në nivel lokal (në zona/qarqe/rrethe/bashki/komuna specifike), kanë fonde të limituara dhe vazhdimësia e tyre varet nga kjo.

Një problem tjetër i identifikuar nga eksperiencia e shumë OJQ-ve që punojnë në këtë fushë, është se këto familje i shikojnë OJQ-t dhe shërbimet e ofruara prej tyre si mbështetëse, të dobishme dhe të besueshme. Problemi është që OJQ-të për shkak se varen nga burime të jashtme dhe jo të vazhdueshme, nuk mund të kenë qëndrueshmërinë e institucioneve shtetërore. Një nga zgjidhjet mund të jetë bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve me qëllim kombinimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësinë e institucioneve shtetërore me eksperiencën dhe aftësitë e OJQ-ve në çështje specifike.

Suporti financiar i OJQ-ve nga shteti mund të jetë një zgjidhje, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë. Zhvillimi i projekteve aftagjata në fushat e përkujdesjes shëndetësore fizike dhe mendore, edukimit dhe zhvillimit të mekanizmave ligjor për fëmijët në situatë rruge, fillimisht në zonat më kritike (pilot) dhe më pas në të gjithë territorin, mund të jetë një zgjidhje e mundshme për shërbime efektive dhe të qëndrueshme.

Një tjetër zgjidhje mund të jetë lidhja e një marrëveshje midis shtetit dhe OJQ-ve sipas të cilës OJQ-të marrin të drejtën (dhe detyrimin) të kryejnë aktivitete (detyra dhe shërbime) të cilat tradicionalisht janë nën kompetencat e shtetit. Ai i cili cakton detyrën – një autoritet qendror ose vendor – mundëson suport financiar ndaj atij që merr detyrën – një OJQ – në formën e subvencionit ose pagesës sipas kontratës. Si alternativë, shteti mund të ofrojë ambjentet, asistencë jo monetare ose suporte të tjera brënda mundësive si palë kontraktuese. Kjo zgjidhje ka qenë e suksesshme në shtete ku administrata shtetërore është bërë e vetëdijshme për tre faktorë. Pikësëpari, të mbështesësh OJQ-t financiarisht nuk është një veprim bamirësie i njëanshëm në mbështetje të sektorit jo qeveritar por

pagesë për një punë apo shërbim të kryer dhe duhet të konsiderohet si një marrdhënie biznesi. Së dyti, partneriteti me OJQ-t në ofrimin e shërbimeve sociale është i dobishëm për të dyja palët dhe për shoqërinë. Së treti, partneriteti ofron forma të përshtatshme dhe të shumëllojshme me qëllim realizimin dhe kontrollin e shpenzimeve të bëra nga shteti nga OJQ-të, duke marrë parasysh interesin publik. Shteti duhet të aplikojë në mënyrë efikase një sërë rregullash të cilat kanë për qëllim parandalimin e abuzimit dhe të shpërndarjes jo të rregullt të aseteve.<sup>19</sup>

### ***Bazuar në observimet çfarë ne rekomandojmë për mirëfunksionimin e sistemit për fëmijët në situatë rruge është:***

- Bashkëpunim më i mirë ndërmjet strukturave dhe institucioneve përgjegjëse. Koordinim efektiv dhe efikas i strukturave lokale dhe aktorëve të shërbimeve sociale. Koordinimi midis strukturave të qeverisë qendrore dhe asaj vendore ka nevojë të forcohet<sup>20</sup>;
- Ngritja e një baze të dhënash të saktë për të pasur një pasqyrim të situatës aktuale të fëmijëve në situatë rruge nëpër të gjithë vendin dhe për të gjitha qarqet e vendit.
- Nevoja për ti ofruar shërbime të specializuara kësaj kategorie fëmijësh në mënyrë imediate dhe profesionale;
- Garantimi i të drejtave thelbësore të njeriut nëpërmjet mbështetjes së nevojave bazike për fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre;
- Mungesa e shërbimeve e bën të vështirë për Policinë të operojë dhe ndërhyjë kur rastet identifikohen;
- Nevoja e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të stafeve lokale të shërbimeve sociale, në përmbushje dhe garantim të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge;
- Mungesë fondesh dhe burimesh lokale nga strukturat përgjegjëse lokale dhe institucionet e mbrojtjes sociale (shtetërore ose jo shtetërore) për ngritjen e një programi të ri të të drejtave sociale në përgjigje të nevojave të identifikuara gjatë vitit;
- Nevoja e forcimit të implementimit të politikave në nivel lokal dhe qendror në për mbrojtjen e fëmijës<sup>21</sup>;
- Të rritëzohen kapacitetet dhe burimet e aktorëve lokal kryesorë në shërbim të fëmijëve;
- Të krijohet një program trajnimi për stafin lokal mbi të drejtat sociale; si të kthehen çështjet sociale në programe sociale ;
- Mungesa e një treguesi i cili mund të ndikojë në punësimin formal dhe jo formal;
- Politikat të cilat kanë për qëllim të shmangin problemin e punësimit të fëmijëve nuk janë efikase;
- Struktura private dhe të palicensuara të cilat nuk deklarojnë punësimin e fëmijëve;
- Implementim i pjesshëm i politikave sociale nga organizatat të cilat mbulojnë problemet e fëmijëve që braktisin shkollën, ose lypin në rrugë;
- Shërbime psiko-sociale të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e të miturve dhe familjeve të tyre në nivel rajonal;

<sup>19</sup> Radost Toftisova (2001), “Bashkëpunimi në Fushën e Shpërndarjes së Shërbimeve Sociale dhe Mekanizmat e Financimit Shtetëror të OJQ-ve(Modele)”, *Ditari Ndërkombëtar i Ligjit mbi mos Përfitim*, Volumi 3(4)

<sup>20</sup>“Shqipëria 2012 Progres Raporti”; Komunikatë e Komisionit të Parlamentit European dhe të Këshillit; Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013; Bruksel, 10.10.2012; faqe 19.

<sup>21</sup>“Shqipëria 2012 Progres Raporti”; Komunikatë e Komisionit të Parlamentit European dhe të Këshillit; Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013; Bruksel, 10.10.2012; faqe 22

- Arsyet të cilat çojnë në këto lloj problemesh duhen analizuar dhe përmes një plani veprimi, duhen përcaktuar detyrat e çdo institucioni, me qëllimin reduktimin e fenomenit nga pikëpamja sasiore dhe cilësore ;
- Përgjithësisht studimet mbi fëmijët në situatë rruge nuk përfshijnë të gjitha qarqet e Shqipërisë. Në përputhje me këtë, këto studime duhet të ofrojnë gjeneralizime nga gjetjet rreth fëmijëve në situatë rruge;
- Nevoja për një plan veprimi i cili përfshin institucionet publike dhe jo-publike me qëllim zbutjen e fenomenit;
- Informacionet rreth fëmijëve në situatë rruge duhet të përfshijnë të dhëna nga numërimet faktike (observime në terren) dhe të dhëna nga institucione publike;
- Nevoja për të rritur pagesën e Ndhmës Ekonomike (NE) pasi ndihmon në zvogëlimin e fenomenit të lypjes dhe problemeve të tjera;
- Fenomeni i fëmijëve në situatë rruge është evident dhe problematik, ndaj dhe është e nevojshme të ngrihen institucione rezidenciale të cilat mund të ofrojnë shërbime, strehim dhe ushqim për këtë kategori;
- Nevoja për përmirësimin e legjislacionit rreth institucioneve rezidenciale. Ekziston një VKM<sup>22</sup> e cila specifikon kriteret që duhet të ketë një fëmijë për të hyrë në institucione rezidenciale, por ka mangësi në legjislacion rreth specifikave të procedurave për nxjerrjen e një fëmije nga këto institucione, për arsye të ndryshme;
- Nevoja për ngritjen e qendrave të emergjencës dhe qendrave të pritjes, bazuar në modelin e aplikuar në Tiranë nga ARSIS e cila ofron strehim dhe transport për fëmijët;
- Nevoja për të forcuar partneritetin dhe bashkëpunimin midis sektoreve publike dhe jo-publike, me qëllim forcimin e kompetencave të secilit. OJQ-t mund të jenë katalizatorët por shteti ka si detyrim të mbështesë dhe të ofrojë vazhdimësinë e këtyre iniciativave;
- Mënyra më e mirë për të lokalizuar fëmijët në situatë rruge është më anë të identifikimit dhe referimit të rasteve në rrugë zyrtare nga secili institucion. Gjithashtu kjo theksohet në shtojcën “Mbi identifikimin dhe referimin e rasteve” në protokollin e punës së Njësisë të Mbrojtjes së Fëmijës.;
- Akte legjislative për familjet/prindërit të cilët shfrytëzojnë fëmijët e tyre;
- Integrimi i personave të cilët janë pjesë e skemës në Ndhmës Ekonomike (NE) në punët komunitare në këmbim të marrjes së pagesës;
- Nevoja për ngritjen e strukturave monitoruese të cilat duhet të mbikqyrin vazhdimësinë e këtyre rasteve, nëse ata kthehen në rrugë apo janë raste plotësisht të suksesshme;

---

<sup>22</sup> VKM nr. 425, dt. 27.06.2012 “Mbi implementimin e kriterëve të nevojshme dhe dokumentave për pranimin e personave në perkujdesje sociale rezidenciale publike dhe private”

## **ANEKS 1, - Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për fëmijët në situatë rruge**

### **1. Legjislacioni ndërkombëtar për fëmijët në situatë rruge**

- *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut* - Kjo konventë është ratifikuar nga Qeveria Shqiptare më 4 Nëntor 1995, ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, Fletore Zyrtare nr. 20 Gusht 1996. Në nenin 4, Konventa ndalon punën pa dëshirë dhe punën e detyruar.
- *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike* - Ky pakt është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 Dhjetor 1966 (ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 7510, datë 08.08.1991, Fletore Zyrtare Nr. 6, Gusht 1991). Në nenin 24 thuhet se “Çdo fëmijë, pa asnjë dallim të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri apo lindje, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit”.
- *Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* - Ky pakt është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 Dhjetor 1966, ratifikuar nga Shqipëria në Gusht 1991. Pakti vendos detyrimin për shtetet ratifikuese të marrjes së masave mbrojtëse speciale për fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe shoqëror. Në nenin 10, kërkohet që Shtetet të përcaktojnë moshën limit nën të cilën puna e Fëmijëve është e ndaluar.
- *Karta Sociale Evropiane* - Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002. Karta Sociale Evropiane vendos veçanërisht këto detyrime për shtetet anëtare:
  - të përcaktohet moshë 15 vjeçare si moshë minimale për punë;
  - të ndalohet puna e fëmijëve gjatë periudhës së shkollës;
  - të kufizohet kohëzgjatja e punës për personat nën moshën 16 vjeç;
  - të vendoset që kohëzgjatja e pushimeve të paguara për personat nën 18 vjeç të jetë 3 javë;
  - të ndalohet puna e natës për personat nën 18 vjeç;
  - të vendoset kontrolli i detyruar tek mjeku për personat nën moshën 18 vjeç të cilët punësohen në vende pune të përcaktuara nga ligji.
- *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, KDF* - u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 Nëntor 1989 dhe është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992. Shtetet palë të kësaj konvente njohin të drejtën e arsimit bazë, të detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë shfrytëzimi.
- *Konventa e ILO-s Nr. 138, Për moshën minimale të pranimit në punë* - Shteti shqiptar e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1999. Shtetet që ratifikojnë Konventën Nr. 138 të ILO-s duhet të marrin një sërë masash për të siguruar ndalimin e punës së fëmijëve dhe të rrisin në mënyrë progresive moshën minimale për punësimin e fëmijëve në përshtatje me zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.
- *Konventa e ILO-s Nr. 182 Për Format më të rënda të punës së Fëmijëve* - Ratifikuar nga Shqipëria më datë 23 Prill 2001, kjo konventë përcakton format më të rënda të punës së fëmijëve

### **2. Legjislacioni kombëtar për fëmijët në situatë rruge**

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* - Në themel të legjislacionit shqiptar qëndron Kushtetuta. Neni 54 i Kushtetutës parashikon një mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga Shteti. Gjithashtu, ajo parashikon të drejtën e çdo fëmije për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë – veçanërisht nën moshën minimale për punë të

fëmijëve – që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën ose zhvillimin e tij normal.

- *Kodi i Punës* - Kodi i Punës trajton, nëpërmjet dispozitave të veçanta, çështjet e punësimit si ndalimin e punës së detyrueshme dhe detyrimin e punëdhënësit për të respektuar punëmarrësin, përfshirë këtu dhe kujdesin për shëndetin. Kodi i Punës nuk ka ndonjë parashikim të veçantë lidhur me punën e detyrueshme të të miturve. Në nenin 98, Kodi i Punës përcakton moshën 16-vjeçare si moshën minimale të pranimit në punë. Ky përcaktim është në përputhje me Konventën Nr. 138 të ILO-s. Gjithashtu, në Kodin e Punës lejohet punësimi i fëmijëve të moshës 14-16 vjeçare por vetëm në punë të lehta dhe në periudhën e pushimeve shkollore. Kodi i Punës përcakton se fusha e veprimtarisë së tij nuk shtrihet mbi familjen. Punët familjare që mund të kryhen nga bashkëshorti, bashkëshortja ose fëmijët përfshihen në nenin 5/c të tij por Kodi nuk parashikon rregullat e punës familjare si dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve që punojnë. Për sa i përket punës në shtëpi, në nenin 15 të Kodit të Punës parashikohet se punëmarrësi që punon në shtëpi, gëzon të njëjtat të drejta si dhe punëmarrësi që punon në një sipërmarrje. Por, përsëri, këtu nuk është përmendur mbrojtja e veçantë në rastet kur fëmijët punojnë në shtëpi.
- *Kodi i Familjes* - Kodi i Familjes, i miratuar nga Parlamenti shqiptar, hyri në fuqi në 21 Dhjetor 2003 dhe nisi të zbatohet në Janar 2004. Përgatitja e Kodit të Familjes, ndonëse zgjati për një periudhë gjashtëvjeçare, nuk solli ndonjë trajtim të veçantë të fëmijës, me gjithë përpjekjet e shoqërisë civile që Kodi të bënte një trajtim dhe mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijës në familje. Sidoqoftë, Kodi i Familjes përfshin disa koncepte të reja një ndër të cilat është “Përgjegjësia Prindërore”. Përpos detyrimit për ushqim dhe përkujdesje, amësisë dhe atësisë, Kodi jep një sërë përkufizimesh një ndër të cilët është edhe ai i “përgjegjësisë prindërore”. Sipas Kodit, përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.
- *Kodi Penal* - nuk përmban një kapitull specifik për krimet kundër fëmijëve dhe dënimin e tyre por e shtrin veprimin e tij ndaj tyre në një sërë kapitujsh dhe nenesh të cilat, sidoqoftë, ende lënë boshllëqe për sa i përket mbrojtjes adekuate të fëmijëve nga krimet apo kundërvajtjet penale. Në janar 2008, Kodi u amendua në disa nene për të zgjeruar veprimin e tij për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi. Këtu përfshihet edhe neni 124 që kishte si qëllim përfshirjen në Kod të veprës penale të abuzimit me fëmijën<sup>23</sup>
- *Ligji për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore*<sup>24</sup> - është një ndër ligjet më të rëndësishme për mirëqenien dhe mbrojtjen sociale të Fëmijëve dhe familjeve në situata të vështira, përfshirë ato në situata të jetesës në rrugë apo situata të tjera ekstreme. Ligji ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë nevojat e tyre jetike.
- *Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës*<sup>25</sup> – në nenin 5 të tij e përcakton në këtë mënyrë parimin e mosdiskriminimit: Mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke garantuar barazinë dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij dhe

<sup>23</sup> Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008 “Mbi disa ndryshime dhe amendime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Paragrafi i ri (b) i Nenit thotë se “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet”

<sup>24</sup> Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005

<sup>25</sup> Ligji nr. 10 347, datë 4.11.2010

eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/ përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.



## ANEKS 2, - RASTET

### Rasti 1:

Vlorë - Davide është një djalë 15 vjeçar, të cilit para disa vitesh i vdes ati. E ëma martohet dhe djalin e lë të afërmit e saj, - sipas pohimeve të djalit.

Nga pamja, Davide duket një fëmijë me zhvillim jo normal për moshën që ai ka. Gjatësia dhe pesha e tij të japin përshtypjen e një fëmije 10 vjeçar. Ai kishte 5 vjet që nuk shkonte në shkollë dhe e kishte braktisur atë në klasën e katërt. Davide ishte i shoqërueshëm me persona më të rritur.

Djali largohet nga të afërmit ku e ëma e kishte lenë në një fshat të Fierit për arsye të pa njohura. Ai vjen në Vlorë dhe i kërkon ndihmë një punonjësi të reparit të zjarrfikëseve në Vlorë. Punonjësi i zjarrfikëses i jep disa të holla për ushqim dhe duke i ardhur keq për këtë fëmijë të ushqyer dhe të veshur keq e merr në shtëpinë e tij në fshatin Lapardha të komunës Kotë të rrethit të Vlorës. E mban në shtëpi për 6 muaj por një ditë Davide sëmuret dhe shtrohet në spitalin rajonal të Vlorës. Diagnoza e tij ishte një sëmundje midis anemisë dhe talasemisë e cila duhej të mbahej nën kontroll me medikamente të vazhdueshme.

Në momentin e parë të shtrimit në spital zotëria i cili mbajti në shtëpi i shpjegon mjekëve historikun se si djali kishte arritur deri tek ai dhe ndihmesën që I kishte dhënë. Mjekët njoftuan policinë e cila shpalli urdhrin e mbrojtjes së menjëhershme të mbrojtjes për këtë fëmijë i cili konsiderohej i gjetur.

Pas një trajtimi mjekësor, Davide shërohet plotësisht, por fati i tij pas daljes nga spitali, nuk dihet. Por ku do të shkojë Davide?

Sipas legjislacionit institucionet rezidenciale ofrojnë shërbime për fëmijë të moshës 0-6 dhe 6-14 vjeç. Davide është 15 vjeç .

- *Çfarë do të bëhet me këtë fëmijë? - A do të jetojë ai përsëri rrugëve?*

Sipas informacioneve të marra gjatë muajit Qershor të vitit 2013, Davide është largua sërish nga të afërmit e tij dhe aktualisht po qëndron dhe jeton rrugëve të qytetit të Vlorës. Eksperti i Observatorit në Vlorë ka telefonuar policinë për të denoncuar rastin dhe përgjigja ka qënë se nëse ai merret nën mbikqyrenj e policisë, atëherë vendi i vetëm i strehimit janë qelitë e burgut, sepse policia nuk ka hapësira të tjera për strehim.

### Rasti 2:

Rasti i një familje Rome e cila jeton në Levan të Fierit. Nëna e fëmijëve quhet Dafina Rakipi, është nga Elbasani, martuar me Shpëtim Muharremin (jo të celebruar) i cili është banor i komunës Levan Fier. Fëmijët e tyre janë Anxhelo Muharremi 2 vjeç dhe Natalia Rakipi 6 vjeç. Familjarët janë shfrytëzuar për lypje nga babai i tyre prej shumë kohësh në Kosovë. Prej 4 vitesh ata janë kthyer nga Kosova dhe çifti është ndarë. Nëna sëbashku me djalin e vogel jeton në Elbasan tek të afërmit e saj, ndërsa babai I cili është rimartuar jeton në Fier sëbashku me vajzën. Nëna pretendon se vajza e saj është në rrezik pasi shfrytëzohet për lypje dhe dhunohet sistematikisht nga i ati dhe gruaja e tij. Sipas saj të afërm të tjerë e kanë njoftuar Dafinën të shkojë të marrë vajzën pasi mund ti rrezikohet jeta nga dhuna dhe keqtrajtimi. E vetmja arsye pse babai e mban vajzën është shfrytëzimi për lypje. Familja Muharremi në periudhën e verës lyp në Vlorë afër Portit dhe flenë në lulishten që ndodhet pranë universitetit të Vlorës.

Sëbashku me punonjësit e NJMF-së së bashkisë Vlorë, NJDF-së së Qarkut Vlorë dhe Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve janë bërë observime dhe takime me familjet rome që ndodhen në zonën e Skelës në Vlorë. Kjo familje në rastin kur dëgjoi se po kërkohet nga institucione shtetërore u zhvendos për disa ditë . Aktualisht punonjesja e NJMF-së së bashkisë Vlorë po punon me këtë rast, dhe thotë se mundësitë e gjetjes së familjes janë të pakta. Nga policia është paksa e vështirë të



zgjidhet kjo çështje pasi maksimumi që mund të bëhet është të marren në komisariat të gjitha familjet për disa orë dhe pastaj të leshohen sërish, sepse nuk ka insitucione ku mund të dërgohen, për më tepër që janë dhe shumë fëmijë në numër. Bëhet fjalë për rreth 10-12 familje me minimumi 4 fëmijë dhe maksimumi 8 fëmijë (të moshës 2 muaj deri në 10 vjeç) të cilat lypin në rrugën Vlorë-skelë dhe flenë gjatë natës në lulishten apo trotuarin pranë Portit/ Universitetit.

### **Rasti 3:**

#### **Rasti i një familje Egjiptiane në Vlorë**

Një familje Egjiptiane e shpërngulur nga Elbasani, aktualisht po jeton në një ndërtesë në qytetin e Vlorës në kushte shumë të vështira. Familja ka 5 fëmijë dhe të gjithë janë djem. Gjatë periudhës së kontaktimit me ta, fëmija më i vogël ishte 6 muaj. Babai kishte më shumë se një vit që kishte ndërruar jetë dhe fëmija kishte mbetur i paregjistruar. Djemtë më të mëdhënj në moshë punonin në një pikë larje makinash në qytet, ndërsa tjetri mbledhë kanace në vendet e grumbullimit të mbeturinave. Dy fëmijët e tjerë shfrytëzoheshin nga e ëma për lypje në rrugë dhe këtë fakt nëna e tyre e pranonte me zë të lartë përpara institucioneve publike përgjegjëse për raste të tilla (NJMF, policia, etj). E vetmja mënyrë mbijetese për ta ishte lypja, ndaj ajo nuk mund ta ndryshonte dot këtë fakt. NJMF e bashkisë Vlorë bëri të pamundurën për të tërhequr fëmijët nga rruga, por si rezultat e mungesës së shërbimeve këta fëmijë vazhdojnë të jetojnë dhe punojnë në rrugët e qytetit të Vlorës.

### **ANEKS 3, - Sistemimi dhe vendosja e fëmijës në institucionet e përkujdesit shoqëror<sup>26</sup>**

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror prindi A i cili ka fëmijën B 7 vjeç paraqet kërkesën për sistemin e fëmijës në institucionet e përkujdesit social. Rasti në fjalë është banor i qytetit të Tiranës. Aktualisht Bashkia e Tiranës nuk ofron shërbime të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë. Në këto kushte Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH është e detyruar të vlerësojë kërkesën e paraqitur nga Prindi A.

Punonjësi Social i Sektorit të Inspektimit të standarteve të përkujdesit shoqëror për fëmijët pranë SHSSH kontakton me prindërit dhe në zbatim të “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror” pasi vlerëson kërkesën e Prindit A (nënë) e cila e ka fëmijën të lindur jashtë martese dhe për rredhana të caktuara nuk mund të kujdest për rritjen e fëmijës, e informon mbi dokumentacionet që duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH ku është ngritur edhe Komisioni i Vlerësimit të Nevojave për sistemin në institucionet e përkujdesit social që ka në përberjen e saj , Punonjës social, mjek, psikolog, jurist etj.

Dokumentacionet që duhet të dorëzojë prindi A:

- Çertifikata e lindjes
- Çertifikata familjare
- 2 fotografi
- Deklaratën e noterizuar të nënës që vërteton braktisjen e fëmijës.
- Kartelën mjeksore dhe kopjen e librit të vaksinimit, epikrizë shëndetësore nëse duhet.
- Dokumentacion shëndetsor për gjëndjen shëndetësore të nënës.
- Dokumentacionet e shkollës
- Vërtetimin e gjëndjes social ekonomike të familjes nga njësia e pushtetit vendor
- Analiza për HIV/AIDS etj

Dokumentacionet e lartpërmendura janë për rastin në fjalë gjithmonë duke u nisur nga kriteret që duhet të plotësojnë rastet për sistemin e tyre në institucion.

Komisioni i Vlerësimit të Nevojave për ofrimin e shërbimeve pranë SHSSH mblidhet një herë në muaj pasi çdo antari të komisioni i kalohet dosja për vlerësim në bazë të dokumentacioneve të dorëzuara.

Komisioni ka rregullorëen e funksionimit të tij i cili është i bazuar në legjislacionin shqiptar.

Spektori i Inspektimit të standarteve të Përkujdesit Social për fëmijët ka data-bazin e të gjitha shërbimeve publike dhe jo-publike të përkujdesit social për fëmijë që ofrohen në Republikën e Shqipërisë.

Prioritet kryesor i Komisionit është vendosja e fëmijës në shërbimin më të përshtatshëm për të duke respektuar llojin e shërbimit më të mirë sipas hierarkisë (kujdestari, fost-care, shtëpi familje, shërbim rezidencialë etj) vendbanimin, moshën, gjininë etj.

Për fëmijën B komisioni vendosi sistemin e tij në Fshatin “SOS”, Tiranë. Punonjësi Social i SHSSH kontakton me Fshatin “SOS” duke i referuar rastin dhe të gjitha dokumentacionet.

Në zbatim të standarteve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në qendrat rezidenciale Fshati “SOS” ka ekipin Multidisiplinar të vlerësimit të nevojave të fëmijës të cilët në vazhdimësi hartojnë edhe planin e përkujdesjes.

Ekipi multidisiplinar vlerëson në terren situatën e fëmijës, familjes, komunitetit ku jeton etj.

Në bazë të raportit harton edhe planin e përkujdesjes ku pjesë e rëndësishme e këtij plani është edhe vetë fëmija të cilit në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme i shpjegohen hapat që do ndiqen në vazhdimësi për sistemin e tij në këtë shërbim dhe respektohet vendimi i fëmijës B i cili është 7 vjeç.

<sup>26</sup> Denada Dibra, Drejtoria e Politikave Sociale në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Fëmija B së bashku me nënën A vizitojnë ambientet e Fshatit “SOS” takohen me Nënën SOS dhe motrat dhe vëllezerit me të cilët do të jetojë, shkollën që do frekuentojë etj.

Nëse Fëmijës B miraton qëndrimin e tij në këtë shërbim në zbatim të planit të përkujdesjes i cili tashmë është i njohur për fëmijën, , ekipi multidisiplianr njofton Komisionin e Vlerësimit të Nevojave pranë SHSSH për sistemimin e fëmijës në shërbimin “SOS”.

Komisioni i Vlerësimit të Nevojave miraton Vendimin e sistemimit të fëmijës në Fshatin “SOS”.

Në zbatim të Udhëzimit 1934 Prot. Dt 18.10.2007 “Për procedurat e sistemimit të personave në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror , publike dhe private” ku përfituesit e shërbimeve rezidenciale Fshati “SOS” ku u vendos të sistemohet fëmija B, paraqet kërkesën për marrjen e kujdestarisë së tyre pranë gjykatës së rrethit të vendbanimit apo vendqëndrimit të fëmijës.

## REFERENCA

Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

*Direktiva Nr.6 e MASH, datë 29.03.2006* “Për regjistrimin në shkollë të fëmijëve Rom të cilët nuk disponojnë çertifikatë lindje”

*Direktiva Nr.32 e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit, datë 04.08.2011,* “Mbi procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për publikimin, printimin , shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore para universitare”

Karta Sociale Europiane

Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë

Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë

Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Konventa e ILO-s Nr. 138, Për moshën minimale të pranimit në punë

Konventa e ILO-s Nr. 182, Për Format më të rënda të punës së Fëmijëve

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, KDF

*Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005,* “Mbi ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”

*Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008* “Mbi disa ndryshime dhe amendime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

*Ligji nr. 144/2013, datë 2.05.2013* “Mbi disa ndryshime dhe amendime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

*Ligji Nr.10107, date 30.3.2009,* “Mbi kujdesin shëndetësor në Shqipëri”

*Ligji Nr. 10347, datë 4.11.2010,* “Mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Radost Toftisova (2001), “Cooperation in the Area of Social Services Delivery and Mechanisms of State Financing of NGOs (Sample Models)”, *The International Journal of Not-Profît Law*, Volumi 3(4)

Strategjia Rajonale për Fëmijë, Qarku Fier 2012-2015

*Save the Children* (2011), Legjislacioni dhe shërbimet publike për fëmijët në situatë rruge

*Shqipëria 2012 Progres Raporti*; Komunikatë e Komisionit të Parlamentit Europian dhe të Këshillit; Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013; Bruksel

UNESCO “Street Children”  
[http://www.unesco.org/education/educprog/street\\_child/english/publicat/deplistreet.pdf](http://www.unesco.org/education/educprog/street_child/english/publicat/deplistreet.pdf)

UN Middle East & Africa Office “Report on the Rapid Situation Assessment (RSA) on street children in Cairo and Alexandria” (2001), Office for Drug Control & Crime Prevention (ODCCP)  
[http://www.unodc.org/pdf/youthnet/egypt\\_street\\_children\\_report.pdf](http://www.unodc.org/pdf/youthnet/egypt_street_children_report.pdf)

VKM nr 212, datë 16.03.2011 “Mbi publikimin, printimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve edukative të sistemit para-universitar”

World Health Organization (WHO) (1993) “A one-way street? Report on Phase I of the Street Children Project” part 3 of 9, [http://www.pangaea.org/street\\_children/world/who3.htm](http://www.pangaea.org/street_children/world/who3.htm)